



BURSA PËR SEMINARET VERORË TË GJUHËS, LETËRSISË DHE KULTURËS BULLGARE 2022

Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Republikës së Bullgarisë ofron 3 (tre) bursa për pedagogët, studentët dhe studiues shqiptarë, të cilët dëshirojnë të marrin pjesë në seminarët verorë të gjuhës, letërsisë dhe kulturës bullgare.

Seminaret do të mbahen përkatësisht:

1. nga Universiteti i Sofjes “Shën Kliment i Ohrit” gjatë periudhës 10 deri më 30 korrik 2022, ku është parashikuar 1 (një) vend nga Shqipëria;
2. nga Universiteti i qytetit Veliko Turnovo “Shenjtoret Kiril dhe Metodij” gjatë periudhës 11 deri më 31 korrik 2022, ku janë parashikuar 2 (dy) vende nga Shqipëria.

Kandidatët e interesuar për seminarët e mësipërme duhet të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Integritimit, Koordinimit, Marrëveshjeve dhe Asistencës në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, **brenda datës 27 maj 2022** dokumentacionin përkatës sipas listës në vijim:

- Kërkesën për ndjekjen e kursit veror të gjuhës bullgare (kërkesa të jetë e nënshkruar nga kandidati dhe të përmbajë adresë e-mail dhe numër kontakti);
- Formularin e aplikimit (bashkëlidhur);
- Diplomën dhe listën e notave;
- Letrën mbështetëse nga Departamenti i Gjuhëve Sllave e Ballkanike të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës, nëse është student i këtij fakulteti;
- Raportin mjekësor;
- Fotokopjen e kartës së identitetit;
- 2 (dy) fotografi.

Pala bullgare përballon shpenzimet për ushqimin, akomodimin, programin mësimor dhe kulturor, ndërsa shpenzimet e udhëtimit vajtje-ardhje si dhe sigurimi shëndetësor do të mbulohen nga vetë pjesëmarrësit e kursit.

Bashkëlidhur këtij njoftimi ndodhen formularët e aplikimit për kurset e mësipërme.

Për më shumë informacion klikoni në link-et e mëposhtëm:

<https://www.slav.uni-sofia.bg/index.php/summer-seminar>

<http://www.uni-vt.bg/eng/?zid=144>